



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Numri i lëndës: 2024:243019

Datë: 29.01.2025

Numri i dokumentit: 06775148

KA.nr.557/24

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarja Vlora Pacolli -Rexhepi, në çështjen juridike të paditësit “Sander” Sh.P.K me NUI: 811455543, me seli ne Gllogoc, e përfaqësuar sipas autorizimit nga Fluture Avdiu avokate, me adresë në Rr. Nekibe Kelmendi, hyrja B kati 3 Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, për shkak të anulimit të njoftimit 01-462/01-38662 të datës 06.08.2024, dhe 01-463/02-31671 te datës 03.07.2024, konform nenit 63 të Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, lidhur me neni 253 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, jashtë seancës me datën 29.01.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSIDEROHET** e tërhequr propozimi i paditësit “Sander” Sh.P.K me NUI: 811455543, me seli ne Gllogoc, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, për shkak të anulimit të njoftimit 01-462/01-38662 të datës 06.08.2024, dhe 01-463/02-31671 te datës 03.07.2024.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

Paditësi “Sander” Sh.P.K me NUI: 811455543, me seli ne Glllogoc, e përfaqësuar sipas autorizimit nga Fluture Avdiu avokate, me adresë në Rr. Nekibe Kelmendi, hyrja B kati 3 Prishtinë, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, për shkak të anulimit të njoftimit 01-462/01-38662 të datës 06.08.2024, dhe 01-463/02-31671 te datës 03.07.2024.

Me datë 19.11.2024 gjykata i ka dërguar vërejtjen për pagesë të taksës gjyqësore që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vërejtjes, ta dorëzojnë dëshminë e pagesës së taksës gjyqësore, duke e njoftuar për pasojat e mosrealizimit te taksës.

Sipas fletë kthesës konstatohet se përfaqësuesja e paditësit Fluture Avdiu vërejtjen për taksë e ka pranuar me datë 25.11.2024. Mirëpo gjykata nuk ka pranuar asnjë dëshmi për pagës te taksës brenda afatit ligjor.

Prandaj gjykata vendosi si ne dispozitiv, ne baze te Nenit 253.5 të LPK-së ku përcaktohet *se në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequri i cilin është njëjte i aplikueshëm edhe për takse për mase te përkohshme.*

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.557/24, datë 29.01.2025

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.